



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 263/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” p.f., në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-45780-02-08-2018, me objekt: Loti 1: “*Materiale elektrike*”, me fond limit 5.347.398 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

Ankimues:

“Vaskë Gaqi” p.f.
Zona Industriale, ish Fabrika e Qumështit, Korçë

Autoriteti kontraktor:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë
Adresa: Rruga “28 Nëntori” nr.1, Lagja.7, Korçë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:


I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3 Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.02.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-45780-02-08-2018, me objekt: Loti 1: “Materiale elektrike”, me fond limit 5.347.398 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 19.02.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 23.02.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.4. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, në datën 28.02.2018 operatori ekonomik “Vaskë Gaqi” p.f. ka

paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” p.f.

II.5. Në datën 02.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 208/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën e paraqitur.

II.6. Në datën 13.03.2018, operatori ekonomik “Vaskë Gaqi” p.f, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 263/2 prot., datë 19.03.2018, të protokolluar me tonën në datën 20.03.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

Arsyeton

III.1. Në datën 09.02.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-45780-02-08-2018, me objekt: Loti 1: “Materiale elektrike”, me fond limit 5.347.398 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

III.1.1. Në datën 19.02.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.2. Në datën 23.02.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.1.3. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, në datën 28.02.2018 operatori ekonomik “Vaskë Gaqi” p.f. ka paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” p.f.

III.1.4. Në datën 02.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 208/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën e paraqitur.

III.1.5. Në datën 13.03.2018, operatori ekonomik “Vaskë Gaqi” p.f, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 263/2 prot., datë 19.03.2018, të protokolluar me tonën në datën 20.03.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* *“Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”.* Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor si edhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Vaskë Gaqi” sh.p.k. është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 28.02.2018. Gjithashtu, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues në datën 02.03.2018, duke e njoftuar për refuzimin e ankesës. Referuar ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar”, parashikohet se ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita që operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Referuar materialeve të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, bashkëlidhur ankesës së paraqitur, vërtetohet se autoriteti kontraktor ka shqyrtuar

ankesën brenda 7 ditëve, dhe në datë 02.03.2018 ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues për refuzimin e saj. Gjithashtu operatori ekonomik ankimues pranon se ka marrë dijeni në datën 02.03.2018 për refuzimin e ankesës së tij. Sipas legjislacionit për prokurimin publik llogaritja e afateve për ankimin pranë Komisionit të Prokurimit Publik fillon nga dita që operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni për refuzimin e ankesës së tij.

III.1.8. Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, K.P.P nga llogaritja e kryer, konstaton se ankimi i dorëzuar pranë KPP nga operatori ekonomik ankimues më datë 13.03.2018 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita kur operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni për refuzimin e ankesës së tij nga autoriteti kontraktor.

III.1.9. Vlen të sqarojmë se nisur nga faktet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi në depozitimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit gjykoj se ankimuesi, prima facie ka respektuar kushtet formale dhe vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit, me qëllim marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të duhur nga ana e autoritetit kontraktor, për verifikimin e fakteve dhe rrethanave përkatëse, të vlefshme për të vlerësuar në lidhje me respektimin e kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues, pa i hyrë në thelb shqyrtimit të pretendimeve të tij, për faktin se respektimi i kushteve formale, dhe konkretisht në lidhje me afatet e ankimit, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, nuk mund të vërtetoheshin vetëm nga dokumentacioni i paraqitur prej tij në depozitimin e ankesës.

III.1.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Vaskë Gaqi” sh.p.k. pranë K.P.P, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.11. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga

operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vaskë Gaqi” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-45780-02-08-2018, me objekt: Loti 1: “Materiale elektrike”, me fond limit 5.347.398 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 482 Protokoli,
Datë 13.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha